

Mbikëqyrja në fokus: KMSHC dhe PACEP II thellojnë bashkëpunimin për rritjen e standardeve në shërbimin civil

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil zhvilloi një takim me përfaqësues të PACEP II, projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), me fokus forcimin e funksionit mbikëqyrës dhe rritjen e efektivitetit në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil.



Komisionerja, znj. Lefterije Lleshi (Luzi), theksoi rolin kyç të institucionit në garantimin e zbatimit të parimeve të meritokracisë, profesionalizmit dhe ligjshmërisë në administratën publike.

“Roli ynë mbikëqyrës është thelbësor për të siguruar zbatim të drejtë dhe të njëtrajtshëm të ligjit në të gjithë sistemin e shërbimit civil,” u shpreh Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke nënvizuar se volumi i lartë i informacionit që gjenerohet nga ky funksion kërkon mjete më efikase për menaxhim dhe analizë.

“Synojmë të rrisim efektivitetin e mbikëqyrjes përmes sistemeve që mundësojnë ndjekje dhe analizë më të saktë të rasteve,” deklaroi Komisionerja.

Palët diskutuan mbi nevojën për forcimin e mekanizmave mbështetës të mbikëqyrjes, përfshirë digjitalizimin dhe zhvillimin e instrumenteve analitike.



Takimi u zhvillua në një frymë konstruktive, me angazhimin për të vijuar bashkëpunimin në funksion të rritjes së standardeve në administratën publike.